

URDHËR
Nr. 27, datë 13.3.2014

PËR PËRCAKTIMIN E SHKELJEVE TË TJERA TË LIGJIT NR. 9049, DATË 10.4.2003 "PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 15, germa "a", të nenit 40, pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, dhe në rregulloren e brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

URDHËROJ:

Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1, germa "d", të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur:

1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve financiare nga subjekti apo personi i lidhur me të, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj:

a) Zyrtari nuk ka plotësuar formularin e duhur të deklarates së interesave privatë, sipas llojit të detyrimit për deklarim ose sipas modelit të formularit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm dhe të botuar në Fletoren Zyrtare.

b) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar të gjitha fletët e formularit të deklarates së interesave privatë ku janë pasqyruar të dhëna lidhur me objektin e deklarimit.

c) Zyrtari nuk ka plotësuar autorizimin dhe nuk ka pasqyruar në deklarimin e tij të interesave privatë faktin nëse ka ose jo persona të tjerë të lidhur me të, sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar.

d) Zyrtari deklaron të dhënat edhe për personat e lidhur, kur këto të fundit disponojnë pasuri të regjistruar veçmas dhe për pasojë detyrohen ligjërisht të plotësojnë fletët përkatëse të këtij formulari.

e) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk deklarojnë sipas kërkesave të formularit të interesave privatë vlerën e të ardhurave neto.

f) Zyrtari nuk ka pasqyruar saktë vlerën e aseteve, të ardhurave apo të detyrimeve sipas monedhës përkatëse.

g) Zyrtari, në deklarimin e interesave privatë periodikë vjetorë apo pas largimit nga funksioni, nuk pasqyron sipas kërkesave ligjore shtesa dhe ndryshime të gjendjes pasurore, por deklaron gjendjen e tyre.

2. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk marrin masa për të rregulluar brenda afatit ligjor pasaktësitë e konstatuara gjatë përpunimit paraprak të deklarates së interesave privatë, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar.

3. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk paraqitet brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave privatë.

4. Subjekti deklarues apo personat e lidhur me të nuk depoziton dokumentet justifikues për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, gjatë kontrollit dhe hetimit administrativ.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj

